



Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo

Agjencia e Kosovës për Akreditim
Agencija Kosova za Akreditaciju
Kosovo Accreditation Agency



Ref.:846/25, Datë:10.07.2025

Në mbështetje të nenit 11 të Ligjit nr. 08/l-110 për Agjencinë e Kosovës për Akreditim (GZ.nr. 13 / 29 qershor 2023, Prishtinë, nenit 7 të Ligjit për Arsimin e Lartë në Republikën e Kosovës Nr. 04/L-037 (GZ, Nr.14/9 Shtator 2011), Ligjit për Procedurën e Përgjithshëm Administrative Nr.05/L-031 (GZ.Nr.20/12 Qershor 2016), Udhëzimi Administrativ (MASHTI) Nr. 01B-03/2024 për vlerësimin e përshtatshmërisë së bartësve të programeve, Rregullorja (AKA) Nr. 04/2024 për Manualin e Akreditimit/Riakreditimit dhe Validimit të Institucioneve të Arsimit të Lartë dhe Programeve të Studimit në Nivelin Baçelor dhe Master, Rregulloren e Punës së Këshillit Shtetëror të Cilësisë, si dhe procesverbalit të mbledhjes 139 të mbajtur më 30.06.2025, mori:

V E N D I M

- I. Riakreditohet Kolegji RIT Kosovo (A.U.K) në nivel institucional, për periudhën pesë (5) vjeçare, (1 tetor 2025 - 30 shtator 2030).
- II. Ky vendim hyn në fuqi me nënshkrimin e tij.

A R S Y E T I M

Kolegji RIT Kosovo (A.U.K) brenda afatit ligjor ka parashtruar kërkesë në Agjencinë e Kosovës për Akreditim, për riakreditim në nivel institucional.

Me qëllim të vlerësimit të institucionit për riakreditim në nivel institucional, AKA ka organizuar vizitat me ekspertë ndërkombëtarë të akreditimit në Kolegjin RIT Kosovo (A.U.K).

Bazuar në nenin 16 të Rregullores (AKA) Nr.03/2024 për procedurat e përzgjedhjes, angazhimit dhe kompensimit të ekspertëve të jashtëm dhe Rregulloren (AKA) Nr.04/2024 për Manualin e Akreditimit/Riakreditimit dhe Validimit të Institucioneve të Arsimit të Lartë dhe Programeve të Studimit në Nivelin Baçelor dhe Master (tutje Manualit), ekipi i vlerësuesve të jashtëm (Ekspertët ndërkombëtar) ka hartuar raportet e vlerësimit për këtë program dhe për fushat e standardeve të akreditimit të parapara në Manualin e Akreditimit ka dhënë konstatimet si në vijim:

Vizita me ekspertët ndërkombëtar të akreditimit është organizuar me 19.05.2025, ekipi i ekspertëve gjatë vizitës ka konstatuar se nga njëmbëdhjetë (11) fushat e standardeve të akreditimit në nivel institucional, është vlerësuar Kolegji RIT Kosovo përmbushë: Plotësisht tetë (8) fusha të standardeve të akreditimit dhe Substancialisht tre (3) fusha të standardeve të akreditimit.

Faqe 1 nga 2

Këshilli Shtetëror i Cilësisë, në mbledhjen e 139-të, të mbajtur më datë 30.06.2025, ka shqyrtuar dokumentacionin e Kolegjit RIT Kosovo dhe duke u bazuar në raportet e ekspertëve ndërkombëtarë të akreditimit gjatë realizimit të vizitave si dhe rekomandimet përfundimtare të dhëna në raportet finale të vlerësimit nga ekspertët e cekur më sipër, vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Këshillë juridike: *Kundër këtij vendimi pala e pa kënaqur mund të parashtroj ankesë në Komisionin e ankesave të AKA, sipas paragrafit 11 të nenit 22 të Ligjit nr. 08/l-110 për Agjencinë e Kosovës për Akreditim në afatin prej 30 ditëve nga dita kur pala është njoftuar për vendimin e KShC-së. Ankesa adresohet përmes organit publik që ka nxjerrë aktin.*


Prof. Asoc. Dr. Hasnija Ilazi

Kryetare e Këshillit Shtetëror të Cilësisë

Vendimi iu dërgohet:

- Kolegjit RIT Kosovo (A.U.K.);
- MASIITI;
- Arkivit të AKA-së.